



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

---

Numri i lëndës: 2020:127811

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 05997540

**C.nr.448/20**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Z.A. dhe V.A., nga Prishtina, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Xh.B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë **15.07.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Z.A. dhe V.A., nga Prishtina, **DETYROHET** e paditura B....., me seli në Prishtinë, qe paditësve, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me datë 05.08.2020, ora 17:50, t’ua paguaj shumat e specifikuara si me poshtë:

**a). Paditësit Zjadin Arifi:**

Dëmi jomaterial:

- Kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 1,300.00 Euro.
- Kompensim në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 1,000.00 Euro.

Dëmi material:

- Kompensim në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 210.00 Euro.
- Kompensim në emër të ndihmës së personit të tretë, shumën prej 210.00 Euro.
- Kompensim në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 64.89 Euro.

**b). Paditëses V.A.:**

Dëmi jomaterial:

- Kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 1,300.00 Euro.
- Kompensim në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 1,000.00 Euro.

Dëmi material:

- Kompensim në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 210.00 Euro.
- Kompensim në emër të ndihmës së personit të tretë, shumën prej 210.00 Euro.
- Kompensim në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 47.00 Euro.

**II. DETYROHET** e paditura që shumat e aprovuara si në pikën I (një) të dispozitivit t'ua paguajë paditësve me kamatë ligjore prej 8%, dhe atë për dëmin jomaterial nga data e nxerrjes së aktgjykimit të datës 15.07.2024, ndërsa për dëmin material nga ngritja e padisë të datës 06.10.2020, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 881.60 Euro, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

**III. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve përtej pjesës së aprovuar si në pikën I (një) të dispozitivit dhe atë, për paditësin Z.A., në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumën prej 1,000.00 Euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1,200.00 Euro, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 105.00 Euro, dhe në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej 105.00 Euro, si dhe për paditësen V.A., në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumën prej 1,000.00 Euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1,200.00 Euro, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 105.00 Euro, dhe në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej 105.00 Euro, **SI E PABAZUAR.**

**A r s y e t i m**

Paditësit në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përmes të autorizuarit të tyre, i kanë propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar, dhe të detyrohet e paditura që t'ua kompensojë paditësve shumat e precizuara në seancën 15.07.2024, dhe atë për paditësin Z.A., për të gjitha format e dëmit material dhe jomaterial, shumën e tërësishme prej 5,194.89 Euro,

dhe paditëses V.A., për të gjitha format e dëmit material dhe jomaterial, shumën e tërësishme prej 5,177.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar në lartësi sipas tarifës së avokateve të Kosovës.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se nuk është kontestuese baza juridike, por kontestuese është lartësia e dëmit, pasi shumat e kërkuara nuk janë në harmoni me të gjeturat në ekspertizat mjekësore dhe me praktikën gjyqësore për rastet e tilla. Sa i përket kërkesave për dëmin material, shpenzimet e mjekimit nuk i ka kontestuar, ndërsa për kërkesat në emër të ushqimit të përforcuar dhe ndihmës së personit të tretë ka propozuar që te refuzohen në mungesë të provave materiale. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar, ndërsa i ka kundërshtuar shpenzimet e procedurës për paditësit lidhur me seancën përgatitore, me arsyetimin se, kjo seance nuk ishte shtyre me fajin e të paditurës.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Raportin policor të aksidentit nr.2020-BR-426, i datës 05.08.2020; Raportin e Emërgjencës nr.12967, i datës 05.08.2020, për V.A.; Raportin e Emërgjencës nr.12968, i datës 05.08.2020, për Z.A.; Ekspertizën Mjekësore të Ortopedisë dhe Psikiatrisë, të datës 18.06.2024, dhe kuponët fiskal në shkresat e lëndës.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi:

Gjykata ka gjetur se, aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën 05.08.2020, rreth orës 17:50, në fshatin..., Komuna e Skenderajt, ku deri të aksidenti ka ardhur si pasojë e vozitjes së pakujdesshme të drejtuesit të automjetit "A", i cili pa u siguruar fare, merrë veprim të kyçjes nga rruga dytësore, në rrugën rajonale Skenderaj-Klinë, i cili me pjesën e përparme të automjetit e godet në pjesën anësore të anës së djathtë automjetin "B", i cili kishte qenë duke lëvizur nga Klina, në drejtim të Skenderajt, dhe pas goditjes automjeti "B" (drejtuesi) humb kontrolli duke dalur jashtë rrugës në anën e djathtë të drejtimit të levizjes, me ç'rast shkaktohen lëndime trupore dhe dëme materiale. Kjo gjendje faktike nuk ka qenë kontestuese por gjykata e ka vërtetuar edhe në bazë të raportit të aksidentit nr.2020-BR-426, i datës 05.08.2020.

Baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuar nga e paditura, prandaj gjykata gjenë se baza juridike që e paditura të jetë përgjegjëse për t'i kompensuar paditësit ka mbështetje në dispozitat nga neni 136 dhe 159 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Për të vërtetuar rrethanën se paditësit kanë pësuar lëndime trupore, gjykata mori për bazë Raportin e Emërgjencës nr.12967, i datës 05.08.2020, për V.A., Raportin e Emërgjencës nr.12968, i datës 05.08.2020, për Z.A., si dhe Ekspertizën Mjekësore të Ortopedisë dhe Psikiatrisë, të datës 18.06.2024, të punuar nga ekspertet Dr.S.D.-Ortoped-Traumatolog dhe Dr.S.B.-Psikiatre.

Ekspertet mjekësorë në bazë të ekzaminimit të drejtpërdrejt dhe të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, kanë konstatuar se, paditësi Z.A., në aksidentin e datës 05.08.2020, ka pësuar ndrydhje dhe përdredhje të regjionit të kokës, qafës dhe regjionit të shpinës, si dhe sindromë të maramendjes. Këto lëndime ekspertet mjekësor i kanë cilësuar si lëndime të lehta trupore, ku paditësi si pasojë e lëndimeve të pësuar ka përjetuar dhembje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditësh, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për 21 ditë dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 8 muajsh.

Paditësi Z.A., ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, e cila është përcjellë me frikë nga vdekja dhe kërcënimi serioz për integritetin e tij; Frikë sekondare e intensitetit të lartë e cila ka zgjatur për 48 orë, e cila është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, ç'rregullim të gjumit, rikujtime të shpeshta të ngjarjes, ç'rregullim të disponimit dhe ankesa të shumta somatike; Frikë sekondare të intensitetit mesatar dhe të ulët e cila ka zgjatur 3 deri 4 muaj, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit anksioz, lodhje në angazhimet minimale, zgjime të herë pas hershme me rikujtime të ngjarjes traumatike, ku frikë dhe pasiguri ka edhe sot e kësaj dite në pjesëmarrje në komunikacion.

Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 21 ditësh, për të kryer disa aktivitete të përditshme jetësore, si veshëmbathje, higjenë personale, ushqim dhe trajtim mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 21 ditësh, i pasur me proteina, minerale dhe vitamina më shumë se ushqimi i zakonshëm. Rehabilitimi fizioterapeutik klimatik ka qenë i nevojshëm 10 ditë në vitin e parë pas aksidentit.

Për paditësen V.A., ekspertet mjekësorë në bazë të ekzaminimit të drejtpërdrejt dhe të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, kanë konstatuar se, paditësja në aksidentin e datës 05.08.2020, ka pësuar ndrydhje të regjionit lubo sakral, regjionit të kokës dhe regjionit të nyjës së këmbës së majtë. Këto lëndime ekspertet mjekësorë i kanë cilësuar si lëndime të lehta trupore, ku paditësja si pasojë e lëndimeve të pësuar ka përjetuar dhembje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditësh, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për 21 ditë dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 8 muajsh.

Paditësja V.A., ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, e cila është përcjellë me frikë nga vdekja dhe kërcënimi serioz për integritetin e saj; Frikë sekondare e intensitetit të lartë e cila ka zgjatur për 48 orë, e cila është manifestuar me ankth, shqetësim, frikë nga invaliditeti, pagjumësi, rikujtim i ngjarjes traumatike, ankesa somatike dhe simpome përcjellëse të reagimit akut ndaj stresit; Frikë sekondare të intensitetit mesatar e cila ka zgjatur për 2 muaj, e përcjellur me indisponim, problem me gjumë, lodhje në angazhimet minimale, painciativë dhe rënie e aktivitetit të përgjithshëm, mungesë koncentrimi dhe motivimi, etj, dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët që ka vazhduar për 3 muaj, ku frikë dhe pasiguri ka edhe sot e kësaj dite në pjesëmarrje në komunikacion.

Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 21 ditësh, për të kryer disa aktivitete të përditshme jetësore, si veshëmbathje, higjenë personale, ushqim dhe trajtim mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 21 ditësh, i pasur me proteina, minerale dhe vitamina më shumë se ushqimi i zakonshëm. Rehabilitimi fizioterapeutik klimatik ka qenë i nevojshëm 10 ditë në vitin e parë pas aksidentit.

Gjykata pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat e administruara që i referohen natyrës dhe pasojave të lëndimeve të pësuar nga paditësit si pasojë e aksidentit e duke marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjeko-ligjorë lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jo material, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në kuptim të nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së, ku përcaktohet se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*,

lidhur me paragrafin 2 ku përcaktohet se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.*

Me këtë rast, gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin-paditësit, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësve.

Gjykata pasi konstatoj rrethanat e rastit duke pasur parasysh, natyrën e lëndimit, me pasoja të shprehura në dhimbje fizike dhe në frikë e cila është manifestuar me ankth, shqetësim, frikë nga invaliditeti, pagjumësi, rikujtim i ngjarjes traumatike, e duke i marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit si moshën e të dëmtuarve, praktikën e mirë gjyqësore, (që i referohet lartësisë së kompensimit), vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes për dëmin material lidhur me ndihmën e personit të tretë dhe për ushqim të përforcuar, gjykata ka marrë për bazë mendimin e ekspertit ortoped i cili është deklaruar se paditësit kanë pasur nevojë për ndihmën e huaj në kohëzgjatje prej 21 ditësh, ndërsa për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje 21 ditësh, dhe mbi këtë vlerësim gjykata vendosi që t'u pranohet kompensimi per secilën kategori nga 10 Euro në ditë, dhe pavarësisht se paditësit nuk kanë ofruar prova materiale për këto dy kategori të dëmit gjykata nisur nga fakti se zakonisht të dëmtuarit këto dy shërbime i marrin brenda familjes ka vendosur që ta pranoj kompensimin mbështetur në mendimin e ekspertit sa i përket nevojës dhe kohëzgjatjes, ndërsa shuma është gjykuar sipas standardit të praktikës gjyqësore, jo më shumë se 10 Euro në ditë, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës e refuzoi si të pabazuar, andaj, edhe kundërshtimet e të paditurës se këto kërkesa duhet të refuzohen në mungesë të provave materiale u vlerësuan si të pabazuara për të vendosur ndryshe.

Ndërkaq, sa i përket dëmit material të krijuar si shpenzime të mjekimit, gjykata pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat e administruara që i referohen shpenzimeve të mjekimit e duke marrë për bazë faturat për shpenzime e tilla, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ndërsa për bazë të kësaj kategorie të dëmit ju referua dispozitës se nenit 179 të LMD-së, ku përcaktohet se:

*“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”.*

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material, gjegjësisht për frikën e përjetuar dhe dhimbjet trupore fizike, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, dhe se lartësia e kërkesës për këtë lloj të dëmit është e lartë dhe në kundërshtim me provat e administruara (mendimi i ekspertëve mjekësor).

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi konform nenit 449 lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve numri tarifor 6, duke ia njohur paditësve shpenzimet e procedurës. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara për paditësit i referohen përpilimit të padisë në shumë prej 156.00 Euro, taksës për padi në shumë prej 20.00 Euro, për ekspertiza mjekësore në shumë prej 300.00 Euro, dhe mbajtjes së dy seanca në shumë prej 405.60 Euro.

Nga të cekurat në kuptim të nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C.nr.448/20, të datës 15.07.2024**

Gjyqtari

Nderim Musa

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.